



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 26.09.2016, në orën: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

Procesverbal

Konstatim: Në bazë të Vendimit të seancës plenare nr. 05-V-357, të dt. 22 shtator 2016, është bërë zëvendësimi i anëtarëve të Komisionit sipas propozimit të grupeve parlamentare. Grupi parlamentar i PDK-së ka caktuar znj. Xhevahire Izmaqu, kryetare të Komisionit, ndërsa z. Zenun Pajaziti mbetet anëtar i Komisionit, nga radhët e LDK-së, në vend të znj. Alma Lama është caktuar z. Agim Kika, ndërsa nga radhët e AAK-së, në vend të z. Pal Lekaj është caktuar z. Lahi Brahimaj.

Në mbledhje morën pjesë: Xhevahire Izmaqu, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Zenun Pajaziti, Agim Kika, Shqipe Pantina, Lahi Brahimaj dhe Jelena Bontiq.

Mungoi: Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: z. Mahir Yagcilar – Ministër i MAP-së, zyrtarë të MAP-së dhe përfaqësuesit e KDI-së.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Xhevahire Izmaqu, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së mbajtur më 16.08. dhe 21.09.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2015;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2.Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së mbajtur më 16.08. dhe 21.09.2016;

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3.Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2015

Xhevahire Izmaku e njoftoi Komisionin,se Qeveria i raporton Kuvendit për gjendjen në shërbimin civil një herë në vit, në bazë tënenit 6, pika 1, të Ligjit për Shërbimin Civil në Kosovë dhe mbi këtë bazë Komisioni shqyrton raportin vjetor për gjendjen në shërbimin civil dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij.

Ajo ia kaloi fjalën ministrit për të prezantuar raportin.

Mahir Yagcilar, tha se, MAP është e autorizuar nga Qeveria që të hartojë raportin mbi gjendjen në Shërbimin Civil dhe të raportoje në Kuvend një herë në vit.

Në proceset reformuese të administratës publike kanë qenë të përfshira edhe institucionet e tjera të administratës publike. Reformimi iShërbimit Civil ka qenë një nder prioritete të MAP-së.

Në raport përfshihet gjendja faktike, procedurat, sfidat, masat disiplinore, rekrutimi, rezultatet, katalogimi i vendeve të punës.

Kujtim Paçaku, pyeti ministrin, lidhur me nenin 8, pika 2, tëLigjit për Shërbimin Civil, i cili përmban përqindjen e të punësuarve të minoriteteve të tjera, në institucionet qendrore dhe lokale dhe sa po zbatohet në praktikë, sepse të dhënat në raport nuk korrespondojnë me gjendjen faktike.

Shqipe Pantina, për të kuptuar gjendjen në shërbimin civil, përveç raportit në fjalë duhet një analizë edhe e disa raporteve të institucioneve të tjera.Ajo tha, se raportit i mungon përmbajtja edhe pse në raport ka shifra, statistika, sidomos nuk ka analizë duke pasur parasysh vërejtjet që jep çdo vit Raporti i progresit.Për shembull, në raport nuk janë të përfshira trajnimet nga IKAP, si dhe pranimi i stafit të ri, gjithashtu pyeti edhe për Ligjin për pagat.

Lahi Brahimaj, pyeti lidhur me degradimin e disa nëpunësve të MAP-së, për të cilët edhe pse gjykata ka vendosur në favor të tyre, ata nuk janë kthyer në punë.

Sadri Ferati, tha se ministria ka një strategji të mirë për shërbimin civil, por që bashkërisht duhet të punohet për objektiva, në këtë kontekst pyeti si të zbatohet dhe të lehtësojmë që veprimet të bëhen më praktike dhe si të krijojmë mekanizma në mënyrë që konkluzionet të jenë më detyruese, gjithashtu pyeti lidhur me punësimet me kontratë mbi vepër.

Mahir Yagcilar, u përgjigj: Në bazë të ligjit, lidhur me punësimin e komuniteteve në institucione përqindja është 10%, ndërsa nëinstitucionet lokale është sipas përfaqësimit të komunitetit dhe përqindjes në komunë.

Sa i përket analizës, kjo është e ndërlidhur me vetë institucionin që përmbledhja e të dhënave të bëhet në mënyrë të besueshme,pranimi i stafit të ri bëhet sipas ligjit dhekritereve, procedurave të

veçanta për çdo institucion. Lidhur me punësimet me kontrata mbi vepër, për shkak të problemeve të krijuara nga këto kontrata edhe pse të punësuarit me kontrata të tilla nuk mund të jenë pjesë e shërbimit civil, duhet të fshihet neni 12.4 i ligjit në fuqi.

Pas diskutimeve, Komisioni me 4 vota “Për” dhe 2 “kundër” - Shqipe Pantina dhe Lahi Brahimaj, miratoi Raportin dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2015.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputetja Xhevahire Izmaqu, kryetare e Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës i raporton Kuvendit të paktën një herë në vit për gjendjen në shërbimin civil.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 26.09.2016, shqyrtoi Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2015 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

4. Të ndryshme

Xhevahire Izmaqu, propozoi mbajtjen e një punëtorie për plotësimin - ndryshimin e Ligjit për RTK-në, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që nëse kanë ndonjë propozim për ndonjë ekspert që do të ndihmonte Komisionin t’i propozojnë në mbledhjen e radhës.

Sadri Ferati, propozoi që të pyetet Bordi i RTK-së, se a kanë bërë ndonjë marrëveshje me ndonjë institucion për mënyrën e parapagimit të RTK-së.

Shqipe Pantina, e njoftoi Komisionin për miratimin e kërkesës së Grupit Parlamentar të VV-së, për formimin e një Komisioni hetimor për RTK-në. Ajo, gjithashtu, e njoftoi Komisionin për mbajtjen e tryezës si aktivitet i fundit, lidhur me monitorimin e Ligjit për OJQ- të dhe të hartojmë raportin me rekomandime për Kuvend e që mund të ketë edhe propozime për plotësim - ndryshim të ligjit në fuqi.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetaria e Komisionit,

Xhevahire Izmaqu